49		F.V. Nastro adezive,Silikon,Shkume ekspansive, Sfungjer rikofon,Gur fleksibel, materiale te tjera konsumi etj per te gjitha instalimet e kondicionimit	kompl	1		
<b>SHUMA D</b>						
<b>E. INSTALIME ELEKTRIKE</b>						
1	4.149/ 2	F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 1.5 mm <sup>2</sup>	ml	300		
2	4.149/ 3	F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 2.5 mm <sup>2</sup>	ml	200		
3	4.149/ 4	F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 4 mm <sup>2</sup>	ml	100		
4	4.149/ 6	F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 10 mm <sup>2</sup>	ml	50		
5	4.149/ 10	F.V. Percjelles bakri izolim PVC N07V-K 35 mm <sup>2</sup>	ml	10		

## Dokumenta Standarde të Tenderit

6	An.	F.V. Kabell elektrik bakri FROR 3x1.5 mm <sup>2</sup>	<i>ml</i>	100		
7	2.487	F.V. Kuti derivacioni me kapak & vida PT-1	<i>copë</i>	9		
8	2.487	F.V. Kuti derivacioni me kapak & vida PT-5	<i>copë</i>	3		
9	2.487	F.V. Kuti derivacioni me kapak & vida PT-7	<i>copë</i>	3		
10	An.	F.V. Kuti derivacioni me kapak & vida PT-8	<i>copë</i>	1		
11	2.487/ a	F.V. Kuti suport pllaket 2 modular	<i>copë</i>	18		
12	2.487/ b	F.V. Kuti suport pllaket 4 modular	<i>copë</i>	36		
13	An.	F.V. Kuti suport pllaket 6 modular	<i>copë</i>	21		
14	An.	F.V. Tapa per kuti celsa priza	<i>copë</i>	36		
15	2.485/ 2	F.V. Celes elektrik 1polar 10A-220V "GEWISS"	<i>copë</i>	6		
16	2.485/ 5	F.V. Celes elektrik 2polar 10A-220V "GEWISS"(deviator)	<i>copë</i>	160		
17	An.	F.V. Celes elektrik 2polar 10A-220V "GEWISS"(konvertitor)	<i>copë</i>	5		
18	An.	Kuti shpernarese elektrike jashte muri 150x110x170mm	<i>cope</i>	40		
19	An.	Kuti shpernarese elektrike brenda muri PT 1,PT 4	<i>cope</i>	5		
20	2.485/ d	F.V. Priza elektrike shuko brenda muri universale	<i>copë</i>	171		
21	An.	F.V. ndriçues plafonier Led Driver 230 V IP 56 inkaso	<i>cope</i>	100		
22	An.	F.V. ndriçues plafonier Led Driver 230 V IP 40 inkaso	<i>cope</i>	103		
23	An.	F.V. ndriçues plafonier Led Driver 230 V IP 40	<i>cope</i>	14		
		<b>SHUMA E</b>				
	<b>F</b>	<b>PUNIME PER RRJETIN E GAZRAVE</b>				
1	F 1	Heqje , riparim ,montim ,kolaudim I rrjetit te gazrave	<i>op</i>	56		
2	F 2	F.V.priza per gazra mjekesore te inkorporuara brenda ne mure O2 dopio	<i>cope</i>	5		
3	F 3	F.V.priza per gazra mjekesore te inkorporuara brenda ne mure N2O dopio	<i>cope</i>	5		
4	F 4	F.V.priza per gazra mjekesore te inkorporuara brenda ne mure CO2 tek	<i>cope</i>	5		
5	F 5	F.V.priza per gazra mjekesore te inkorporuara brenda ne mure AC4 dopio	<i>cope</i>	5		
6	F 6	F.V.priza per gazra mjekesore te inkorporuara brenda ne mure VAKUMI tek	<i>cope</i>	5		
		<b>SHUMA F</b>				

Dokumenta Standarde të Tenderit

		<b>SHMA A+B+C+D+E+F</b>				
		<b>TVSh 20%</b>				
		<b>Shuma me TVSH</b>				
		<b>PAISJE</b>				
		<b>MAKINERI DHE PAJISJE MEKANIKE</b>				
	<b>I</b>	<b>- Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri</b>				
		<b>Makineri e pajisje</b>				
1		F. Pompa e zjarrit Karakteristikat Teknike: - Fuqia e instaluar : (2x1.5)kW, - Intensiteti i rrymës : (2x3.6) A, - Tensioni i dhenë : 3F~400V,50Hz - Prurja: 14.5 m <sup>3</sup> / h - Prevalenca: 35 mkH2O - Lidhjet: Ø 2 1/2" / PN 10	cope	1		
2		F. Grupi i lidhjes me motopompen per hidrant DN70. Vendosja ne kase te jashtme, llamarine çeliku te emaluar ne ngjyre, te kuçe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2" (DN 50) materiali i grupit bronz.	cope	1		
4		F. Fikse zjarri meCO2, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartesia 640 mm.	cope	2		
5		F. Fikse zjarri me pluhur, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartesia 640 mm.	cope	4		
		<b>Shuma 1</b>	<b>Leke</b>			
	<b>II</b>	<b>- Sistemi I Ujit Sanitar</b>				
		<b>Pajisjet hidrosanitare</b>				
1		F.Pompa e ujit sanitar Karakteristikat Teknike: - Fuqia e instaluar : (2x0.75)kW, - Intensiteti i rrymës : (2x1.7) A, - Tensioni i dhenë : 3F~400V,50Hz - Prurja: 9 m <sup>3</sup> / h - Prevalenca: 25 mkH2O - Lidhjet: Ø 2 " / PN 10	cope	1		

## Dokumenta Standarde të Tenderit

2	<p>F. -Autokllave me Karakteristikat Teknike: me membranë          -Presioni maksimal 10 bar,          -Kapaciteti 300 lit          -De = 650          -H = 1250          -Lidhjet: F Ø 1 1/4"</p>	cope	1		
3	<p>F.Rezervuar zingato per furnizimin me uje, kapaciteti 5 000 lit,          De=1600 mm, H=2550 mm, lidhjet Ø 2".</p>	cope	4		
4	<p>F. Lavaman i varur ( 65 x 51 ) cm + mishelator</p>	cope	30		
5	<p>F. Lavaman per banjo handikap + mishelator + strukture lavamani</p>	cope	1		
6	<p>F. Kasete WC porcelani, tip modern (67 x 36) cm +rezervuar (flash box) + ndenjese plastike</p>	cope	18		
7	<p>F. Kasete WC per banjo handikap+rezervuar (flash box) + ndenjese plastike +doreza metalike</p>	cope	1		
8	<p>F. Mishelator inkaso per bidene</p>	cope	14		
9	<p>F. Minivalvula nderperese per pajisjet hidrosanitare</p>	cope	109		
10	<p>F. CHILLER Nr. 1 - Uji u ngrohete sanitar.          (Pompe nxehtesie, ajer / uje, prodhim uji te ngrohete sanitar deri ne 65°C , komplet me kitin hidraulik). Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1°C : 35.5 / 42.3 kW .          Temp. te jashtme vere / dimer : 36°C / -1°C - 6130 l/h. Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti /ushqimi : 12.1 kW / 400V / 28 A / 3 F ~ 50Hz . Kit hidraulik ( akumulator, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi, valvol, etj..). Grup mbushje automatike, sensor komplet. dhe mbrojtje automatike kunder ngrirjes.Kompletuar me strukture metalike mbeshtetse me amortizator.          Pesha 804 kg</p>	kompl	1		

## Dokumenta Standarde të Tenderit

11		<p>F. Filter rere me karakteristika teknike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diametri i enës: Ø400</li> <li>- Diametri hyrje/dalje me fileto: 40 mm / 1 1/2 "</li> <li>- Prurja : 6 - 10 m<sup>3</sup>/h</li> <li>- Thellësia e shtratit: 500 mm</li> <li>- Volumi i shtratit të enës: 65 lit</li> <li>- Volumi i enës : 90 lit</li> <li>- Temperatura max. 60 °C;</li> <li>- Presioni maximal i punës 6.5 bar;</li> <li>- Presioni i testimit: 10 bar;</li> </ul>	cope	1		
12		<p>F. Pompa e riqarkullimit te ujit te ngrohje sanitar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fuqia e instaluar : 0.1 kW,</li> <li>- Intensiteti i rrymës : 0.41 A,</li> <li>- Tensioni i dhenë : 1F~230V,50Hz</li> <li>- Prurja: 2.5 m<sup>3</sup> / h</li> <li>- Prevalenca: 3 mkH<sub>2</sub>O</li> <li>- Lidhjet: Ø 1 1/4"/ PN 10</li> </ul>	kompl	1		
13		<p>F. Ena e zgjerimit per akumulim aksessore me karakteristikat teknike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ene zgjerimi me membranë</li> <li>-Presioni min /max: 9 bar,</li> <li>-Temperatura max e punes 99 °C</li> <li>-Kapaciteti 35 lit</li> <li>-De = 404 mm</li> <li>-H = 408 mm</li> <li>-Lidhjet: F Ø 3/4"</li> </ul>	cope	1		
14		<p>F. Akumuli i ujit e ngrohje sanitarI kompletuar me te gjitha aksesoret , me karakteristikat teknike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kapaciteti : 1500 l</li> <li>- Diametri : 950 mm</li> <li>- Lartesi : 2390 mm</li> <li>- Lidhjet hyrje/dalje : 1 1/2"</li> <li>- Temp. max 90°C</li> <li>- Presioni max 12 bar</li> <li>-Siperfaqja e serpentines: 3m<sup>2</sup></li> </ul>	cope	1		
		<b>Shuma 2</b>				
	<b>III</b>	<b>- Sistemi Ajrit te Kondicionuar</b>				
		<b>Njesi terminale te brendshme</b>				
1		<p>F. Fan Coil kanalore, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 4.45 / 5.25 kW, prurja e ajrit Vmax.=600m<sup>3</sup>/h, P.u 765 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe + pult kontrolli.</p>	cope	9		

## Dokumenta Standarde të Tenderit

2	F. Fan Coil kanalore, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.8 / 3.55 kW, prurja e ajrit Vmax.=450m <sup>3</sup> /h, P.u 765 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe + pult kontrolli.	cope	2		
3	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 1 / 1.36 kW, prurja e ajrit Vmax.=200m <sup>3</sup> /h, P.u 241 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	2		
4	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 1.2 / 1.7 kW, prurja e ajrit Vmax.=240m <sup>3</sup> /h, P.u 250 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	4		
5	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 1.73 / 2.32 kW, prurja e ajrit Vmax.=290m <sup>3</sup> /h, P.u 340 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	1		
6	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.21 / 3.38 kW, prurja e ajrit Vmax.=450m <sup>3</sup> /h, P.u 427 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	3		
7	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.8 / 3.55 kW, prurja e ajrit Vmax.=450m <sup>3</sup> /h, P.u 503 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	5		
8	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.4 / 4.24 kW, prurja e ajrit Vmax.=600m <sup>3</sup> /h, P.u 636 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	6		
9	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 4.86 / 6.46 kW, prurja e ajrit Vmax.=920m <sup>3</sup> /h, P.u 1110 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	1		
10	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 6.35 / 7.81kW, prurja e ajrit Vmax.=920m <sup>3</sup> /h, P.u 1230 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	3		
11	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.42 / 10.4kW, prurja e ajrit Vmax.=920m <sup>3</sup> /h, P.u 1092 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	3		
12	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.62/ 9.67 kW, prurja e ajrit Vmax.=1300m <sup>3</sup> /h, P.u 1464 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	1		
13	F. Fan Coil tip dysHEMEJE, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 8.6/ 10.4 kW, prurja e ajrit Vmax.=1140m <sup>3</sup> /h, P.u 1471 l/h kompletuar me Valvol tre kalimshe.	cope	4		



Dokumenta Standarde të Tenderit

14	F. Njesi Rikuperatore Ajri V.ajri. 1850 m <sup>3</sup> /h ~ Presioni statik 80 Pa, Kap.Rekuperimi Ngrohje 54% ~ 9.2 kW, Kap.Rekuperimi Ftohje 47% ~ 1.73 kW, Kap.Rekuperimi Ftohje 47% ~ 1.73 kW	cope	1		
15	F. Mono Split 9000 BTU Inverter.	cope	2		
	<b>Njesi te jashtme</b>				
16	<p>UTA 1 - Njesi trajtimi ajri - Blloku i operacionit                      Prurja e ajrit dergim/kthim 8500 / 6900 m<sup>3</sup>/h .                      Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 450/450 Pa.                      Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje 98.99 / 57.91 kW .                      Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 4.0 kW 3 F+N/400V/50Hz / kthim 4.0 kW 3 F+ N/400V/50Hz kompletuar me inverter shpejtesie. Efikasiteti i rekuperatorit 58.1 %. Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik me akses BMS, set i valvolave 3 kalimshe per baterite. Struktura e tipit te jashtem.                      Dimensionet AxBxH [mm]: 1360x5790x2110. Pesha neto / totale 1980/2078 kg).</p>	cope	1		
17	<p>UTA 2 - Njesi trajtimi ajri - ( Dhomat e vizitave dhe zyrat)                      Prurja e ajrit dergim/kthim 4700 / 4900 m<sup>3</sup>/h .                      Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 200/200 Pa.                      Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje 32.75 / 29.47 kW .                      Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 2.2 kW 3 F+N/400V/50Hz / kthim 2.2 kW 3 F+ N/400V/50Hz kompletuar me inverter shpejtesie. Efikasiteti i rekuperatorit 62.3 %. Komplet filtrash, komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik, set i valvolave 3 kalimshe per baterite. Struktura e tipit te jashtem.                      Dimensionet AxBxH [mm]: 1360x5270x1500. Pesha neto / totale 1434/1512 kg).</p>	cope	1		

## Dokumenta Standarde të Tenderit

18	<p>UTA 3 - Njesi trajtimi ajri ( Dhomat e shtrimit )                  Prurja e ajrit dergim/kthim 2600 / 2700 m<sup>3</sup>/h .                  Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 200/200 Pa.                  Kapaciteti termik ne ngrohje / ftohje 21.62 / 14.57 kW .                  Fuqia elektrike e ventilatorit, dergim 1.5kW 3 F+N/400V/50Hz /                  kthim 1.1kW 3 F+ N/400V/50Hz kompletuar me inverter                  shpejtesie. Efikasiteti i rekuperatorit 48.4 %. Komplet filtrash,                  komplet kuader elektrik, set sensoresh, rregullator klimaterik, set                  i valvolave 3 kalimshe per baterite. Struktura e tipit te jashtem.                  Dimensionet AxBxH [mm]: 750x5230x1500. Pesha neto / totale                  958/1016 kg).</p>	cope	1		
19	<p>CHILLER 1 - UTA 1 - ( Blloku i operimit )                  (Versioni pompe nxehtesie ajer / uje, komplet me kitin hidraulik).                  Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1°C : 83 / 99 kW .                  Temp. te jashtme vere / dimer : 36°C / -1°C - 14280 l/h                  Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 39 kW / 400V / 3 F ~ 50Hz .                  Kit hidraulik ( akumulator, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi,                  valvol, Termosat komandimi ne distance etj..). Grup mbushje                  automatike, sensor komplet dhe mbrojtje automatike kunder                  ngrirjes. Kompletuar me                  strukture metalike mbeshtetse me amortizator. Pesha 1099 kg</p>	cope	1		

## Dokumenta Standarde të Tenderit

20	<p>CHILLER 2 - UTA 2 + UTA 3 ( dhomat e shtrimit + Dhomat e vizitave dhe zyrat )                  (Versioni pompe nxehtesie ajer / uje, komplet me kitin hidraulik).                  Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1°C : 51/ 58 kW .                  Temp. te jashtme vere / dimer : 36°C / -1°C - 8770 l/h                  Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 20.1 kW / 400V / 3 F ~ 50Hz .                  Kit hidraulik ( akumulator, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi, valvol, Termosat komandimi ne distance etj.). Grup mbushje automatike, sensor komplet dhe mbrojtje automatike kunder ngrirjes.Kompletuar me strukture metalike mbeshtetse me amortizator. Pesha 730 kg</p>	cope	1		
21	<p>CHILLER 3 - Fan Coila                  (Versioni pompe nxehtesie ajer / uje, komplet me kitin hidraulik).                  Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1°C : 201 / 227 kW .                  Temp. te jashtme vere / dimer : 36°C / -1°C - 38180 l/h                  Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 90 kW / 400V / 3 F ~ 50Hz .                  Kit hidraulik ( akumulator, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi, valvol, Termosat komandimi ne distance. etj..). Grup mbushje automatike, sensor komplet dhe mbrojtje automatike kunder ngrirjes.Kompletuar me strukture metalike mbeshtetse me amortizator. Pesha 1800 kg</p>	cope	1		
22	<p>Gjenerator avulli                  me karakteristikat teknike:                  -Kapaciteti i prodhimit te avullit 90 kg/h                  -Fuqia elektrike 34 kW                  -(400V - 3~ 50Hz)                  -Pesha 64 kg</p>	cope	1		
23	<p>Vent. Centrifugal                  Type: CVD 3/8                  V = 460m<sup>3</sup>/h                  ΔP= 60 Pa                  Fel=70 Wat</p>	cope	1		
	<b>Shuma 3</b>	<b>Leke</b>			
	<b>SHUMA PAISJE</b>				
	<b>SHUMA TOTAL</b>				

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

## NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

### Shtojca 16

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohej sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

### Shtojca 17

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:



Dokumenta Standarde të Tenderit

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtim ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të

projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të reze dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 17: Zbulimet**

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

**Neni 18: Disponimi i Kantierit**

- 18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

**Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

- 19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .
- 19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

**Neni 20: Paralajmërimi në Kohë**

- 20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

**Neni 21: Kontrolli i Cilësisë**

- 21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
- 21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.
- 21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.
- 21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

**Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara**

- 22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti

të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

**Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor**

- 23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:
- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
  - (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

**Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit**

- 24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

**Neni 25: Sigurimi**

- 25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumën e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.
